

REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E FINANCAVE,
PUNËS DHE TRANSFEREVE
DOGANA E KOSOVËS

RAPORTI VJETOR DOGANA E KOSOVËS VITI 2023



📍 Prishtinë, 2024

Lista e shkurtesave

DK	Dogana e Kosovës
AEO	Operatorët e Autorizuar Ekonomik
CEFTA	Marrëveshja e tregtisë së lirë e Evropës Qendrore
DP	Drejtori i Përgjithshëm
DDR	Departamentet Doganore Rajonale
DUD	Dokumenti Unik Doganor
DPI	E drejta e Pronësisë Intelektuale
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MSA	Marrëveshja e stabilizim asocimit
UE	Unioni European
BK	Buxheti i Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MPBAP	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
SSP	Spektori i Standardeve Profesionale
SEEMS	Sistemi i Menaxhimit i të dhënave për Evropën Jug-lindore
PMNE	Procedurat Doganore me ndikim ekonomik
OBD	Organizata Botërore e Doganave
PT	Plani i Trajnimeve
ST	Spektori i trajnimeve
AKK	Agjencioni kundër korrupsionit
KD	Komisioni Disiplinor
GJTH	Gjykata themelore
SPPD	Spektori për Pajtuëshmërinë e Procedurave Operative Doganore
LPP,LQP,LMP,PTI	Procedural e ndërlidhura me pakot fiskale
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit
LES	Law Enforcement Information System
QRKS	Qeveria e Republikës së Kosovës

Përgatitur nga:

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Kopjet e tjera të këtij dokumenti mund të merren nga:

Zyra për media, Drejtoria e Doganës, Prishtinë - Republika e Kosovës.

Tel: 038 540 796 Fax: 038 540 065 E-mail: info@dogana-ks.org

Raporti është gjithashtu në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të Doganës:

www.dogana-ks.org

Qershor, 2024

VITI 2022/2023 - STATISTIKAT

Mbledhja e të Hyrave €'000	2022	2023	ndryshimi në %
Të hyrat totale	1,531.31	1,673.04	+9.26%
Taksa doganore	132,66	156,21	+17.76%
Akciza	517,26	554,98	+7.30%
TVSH-ja	875,38	957,67	+9,40%
Buxheti dhe Shpenzimet			
Buxheti vjetor	9.8	14,8	+33%
Paga dhe mëditje	5.8	6,2	6.5%
Mallra dhe shërbime	2.09	2.5	16.4 %
Komunali	0.64	0,63	1.5%
Shpenzime Kapitale	1.87	2,3	18.7%
Kthimi i investimit (indikator)			
Shpenzimet/të hyrat	0.006	0.008	25%
Vlera e mallrave në import €'000			
Vlera e Importit (IM4)	5.6 miliard	5,8 miliard	+4.91%
Pesha neto në Import (IM4)	4.7 milion kg	5.1 miliard kg	7.8%
Vlera e mallrave në eksport €'000			
Vlera e Eksportit (EX1)	869.6 milion €	819.6 milion €	-5.67%
Pesha neto në Eksport (EX1)	837.4 milion kg	867,3 milion kg	+3.59%
Statistikat e operimeve			
Numri i ankesave	914	1113	17.9%
Numri i kundërvajtjeve	1795	1922	6.6%
Kallëzimet penale	69	114	39.5%
Vlera e shmangieve sipas kallëzimeve penale	2.8 milion €	2,3	-21.8%
Vlera e mallrave te sekuestruara	6.2 milion €	14.5	57%
Gjoha	1.8 milion €	2,435,579.00	25%
Vlera e deklaruar vullnetare	94%	95%	+1%

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar lexues,

Është kënaqësi e madhe për mua të ndaj me ju arritjet dhe progresin e Doganës gjatë vitit 2023. Ky vit ka qenë një periudhë dinamike, plot sfida dhe suksese të jashtëzakonshme që kanë reflektuar përkushtimin dhe profesionalizmin e secilit prej nesh. Gjatë këtij viti, Dogana e Kosovës ka grumbulluar të hyra në vlerë prej mbi 1.661 miliardë €, një rritje prej 135 milionë € ose mbi 9.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 (1.531 miliardë €). Kjo arritje vjen pavarësisht thellimit të lirimeve si rezultat i ndryshimit të pakos fiskale sipas vendimit të Qeverisë.

Vlera e mallrave të importuara ka arritur në 5.818 miliardë €, një rritje prej 5.46% krahasuar me vitin paraprak. Ndërkohë, vlera e mallrave të eksportuara ka arritur në 891 milionë €, me një peshë prej 874,835 tonësh, duke shënuar një rritje në peshë prej 2%.

Luftimi i ekonomisë joformale ka arritur një efekt parandalues prej 27.4 milionë €, një rritje prej 19.8% krahasuar me vitin e kaluar. Vlera e mallrave të konfiskuara dhe sekuestruara ka arritur në 14.5 milionë €, një rritje prej 27.4%. Ne kemi parandaluar hyrjen e mallrave të ndaluara si marihuana dhe armë, duke krijuar lehtësira për bizneset përmes licencimit të 4 AEO-ve dhe eliminimit të garancioneve bankare për përpunuesit.

Përkushtimi ynë në luftën kundër korrupsionit ka rezultuar në arrestimin e zyrtarëve doganorë, duke luftuar kështu krimin nga brenda dhe duke mbajtur parimin tonë të ZERO TOLERANCËS ndaj kësaj dukurie.

Dogana e Kosovës ka treguar rezultate të mëdha në zbulimin e mallrave të ndaluara, të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në taksa, por kanë një efekt të madh në mbrojtjen e shoqërisë. Ne kemi parandaluar hyrjen e afro 110 kg marihuanë, kokainë në sasi të vogla, stimulues të ndryshëm me afat të skaduar, medikamente, telefona mobilë të fshehura në bunkerë, para false dhe mjete monetare të padeklaruara.

Në drejtim të parandalimit të armëve dhe municionit, kemi ndaluar 5 armë zjarri dhe 560 copë municion (dylbi, kondak, fishekë etj). Gjithashtu, kemi trajtuar 4 raste për pastrim të parave, gjithnjë në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale, dhe në dy raste janë nxjerrë aktgjykime dënuese.

- **Kalimi nga терминалет private në терминале të marra me qira nga shteti:** Ky hap do të sjellë përfitime të mëdha në eficiencën dhe menaxhimin e proceseve doganore.
- **Vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të OBD-së:** Vizita e tij ka vlerësuar lart arritjet e Doganës së Kosovës dhe përkushtimin tonë për përmirësim të vazhdueshëm.

- **Raporti i KE 2023:** Ky raport vlerëson pozitivisht progresin e Doganës së Kosovës në fushën e legjislacionit, krijimin e lehtësirave tregtare, dhe luftimin e kontrabandës së mallrave dhe narkotikëve.

Në përfundim, dua të falënderoj oficeret doganor për punën dhe përkushtimin e treguar gjatë këtij viti. Së bashku, kemi arritur të realizojmë qëllimet tona dhe të vendosim standarde të larta në punën tonë. Le të vazhdojmë të punojmë me të njëjtin përkushtim dhe profesionalizëm për të siguruar një mjedis më të drejtë dhe efikas për të gjithë.

Faleminderit!

Agron Llugaliu

Drejtore i Përgjithshëm

PËRMBAJTJA

1. MBLEDHJA E TË HYRAVE	8
2. LEHTËSIRAT PËR BIZNESE	11
3. ZHVILLIMI I SISTEMEVE DHE PROCEDURAVE	13
4. LEGJISLACIONI	15
5. ZBATIMIT I LIGJIT	16
6. AKCIZA	18
7. LUFTIMI I KORRUPSIONIT	19
8. BUXHETI DHE FINANCAT	20
9. OPERACIONET E VEÇANTA KUNDËR KONTRABANDIMIT	22
10. PARANDALIMI I KONTRABANDËS	24

1. MBLEDHJA E TË HYRAVE

Gjatë këtij viti, janë grumbulluar të hyra në vlerë prej mbi 1.661 miliardë €, krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin 2022 (1.531 miliardë €). Kjo përfaqëson një rritje në grumbullimin e të hyrave prej 135 milionë € ose mbi 9.5%, edhe pse kemi patur një thellim të lirimeve. Njëherit është tejkaluar për 12 milion euro projeksioni i paraparë nga Qeveria që ishte në shumë prej 1,661 mil.euro. Gjithashtu sasia (pesha neto) në import është rritur për 8.28% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e mallit të importuar është 5,878 mil.€, apo 4.91% më shumë se sa vitin e kaluar.

1.1. Të hyrat

Të hyrat e realizuara në periudhën Janar-Dhjetor 2023 kanë shënuar rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, përkundër politikave fiskale siç janë ndikimi i MSA-se, MTL me Turqinë dhe lirimet nga detyrimet për lëndën e parë për prodhuesit.

Taksat sipas llojeve	Janar-Dhjetor 2023 në mil. €	Janar-Dhjetor 2022 në mil. €	Përqindja %
Vlera e mallit në import	5,878	5,603	+4.91%
Doganë	156,21	132,66	+17.76%
Akcize	554,98	517,26	+7.30%
TVSH	957,67	875,38	+9.40%
Të tjera	4,16	6,00	-%30.66
Total taksa	1,673.04	1,531.31	+9.26%

Tabela e inkasimit të taksave Janar-Dhjetor 2023/2022

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë inkasuar **1,673.04** mil.€, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar që ishin **1,531.31** mil.€, janë inkasuar rreth **141,72** mil.€ më shumë të hyra apo 9.26%.

Rritja e të hyrave kryesisht mund t'i atribuohet rritjes së vlerës së mallit në import, sidomos rritjes së vlerës importit të produkteve me akcizë, respektivisht mallrave strategjike (derivatet e naftës dhe produktet e duhanit,) si dhe ngritjes së performancës së punës së Doganës.

Performanca e Doganës në aspektin e mbledhje së taksave nga produktet strategjike, produkte këto që kanë sjellur rreth **880,3** mil.€ apo rreth **52.62%** e të hyrave të përgjithshme nga importi. Është e rëndësishme të theksohet se gjatë kësaj periudhe kemi

rritje të sasisë së importit të derivateve të naftës, rritje të sasisë së duhanit dhe rritje të importit të veturave.

Muaji	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2022	Përqindja %
Derivatet e Naftës (2710)	Taksa 452,44 mil.€	Taksa 436,66 mil.€	+3.62%
Cigare (2402)	Taksa 297,59 mil.€	Taksa 281,65 mil.€	+5.66%
Veturat (8703)	Taksa 130,27 mil.€	Taksa 91,12 mil.€	+42.97%

Tabela e importit të mallrave strategjike (naftë, cigare, vetura) Janar-Dhjetor 2023/2022

Në aspektin e proceseve të punës Dogana ka procesuar një numër të madh të deklaratave afër gjysëm milion deklarata janë procesuar si në aspektin e importit poashtu edhe në aspektin e procedurave tjera si eksporti, importet nga persona fizik etj. Tabela në vijim tregon rritjen e kapaciteteve të përpunimit të deklaratave e që krahasuar me vitin e kaluar tregohet rritje mbi 11 %. Kjo rritje i atribuohet rritjes së performancës si dhe rritjes së cilësive të proceseve punuese brenda institucionit. Fluksi i Zhdoganimeve – në periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë proceduar gjithsejtë 437,757 Deklarata Doganore derisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë proceduar 449,264. Janë 11,507 deklarata doganore më pak apo -2.56% . Numri i Deklaratave Doganore në import (IM4, IM5, IM6, IM7, IM9) është 331,506 DUD-a, ndërsa në eksport 95,908 DUD-a.

Numri i deklaratave	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2022	Përqindja %
Import të gjitha regjimet	366,915	331,501	+10.69%
Eksport të gjitha regjimet	108,881	95,908	+ 13.51%
Importi i personave fizik-DU4	10,490	9,696	+13.53%
Akciza e Brendshme-ED4	678	645	+5.12%
Gjithsejtë deklarata	486,964	437,750	+11,25%

Tabela e deklaratave Janar-Dhjetor 2023/2022

Derisa operative e kufirit gjatë kontrolleve të ushtruar nga oficeret doganore janë zbuluar gjithsejtë 1,317 kundërvajtje doganore, të rregullta dhe mandatore , krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit kaluar kemi 111 kundërvajtje më shumë.

Lloji i kundërvajtjes	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2022	Krahasimi %
Te rregullta	1,118	1,007	+11.03%
Mandatore	199	199	0.0%
Total numri	1,317	1,206	+9.21%

Tabela krahasuese e kundërvajtjeve Janar-Dhjetor 2023/2022

1.2 Eksporti

Në periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 sa i përket vlerës së mallrave dhe peshës së eksportit kemi rënie në vlerë dhe rritje në sasi (peshë) krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022.

Muaji	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2022	Përqindja %
Sasia mil.kg.	867,31 mil/kg	837,31 mil/kg	+3.59%
Vlera e eksportit	819,64 mil. €	868,90 mil.€	-5.67%

Tabela e eksporti te rregullt EX1¹ (10 00) Janar-Dhjetor 2023/2022

Në periudhën Janar-Dhjetor EKSPORTI - EX1 i mallrave Kosovare ka shënuar rënie në vlerë prej -5.67% , kurse rritje në sasi (peshë) për 3.59%. Kryesisht rënie ne vlerë ne eksport ka pasur tek produktet e kreut 94 (mobilieritë, krevatet dhe dyshekët) me rreth -14%, si dhe kreu 72 (çeliku dhe giza) me rreth -26%.

¹ Raporti i DK PERFORMANCA

2. LEHTËSIRAT PËR BIZNESE

Lehtësimi i Tregtisë si Prioritet Kryesor i Doganave gjatë vitit të fundit është vërejtur një përparim i dukshëm në këtë drejtim. Në raportin aktual, shohim një rritje të ndjeshme në aplikimin e lirimeve nga pagesa e taksave doganore, duke zvogëluar barrat administrative për tregtarët dhe bizneset.

Lehtësimet e procedurave doganore dhe zvogëlimi i taksave janë elementë kyç në strategjitë e doganave në mbarë botën. Këto masa jo vetëm që ndihmojnë në realizimin e objektivave strategjike të doganave, por gjithashtu sjellin përfitime të shumta për ekonominë kombëtare. Rritja e lirimeve dhe lehtësimet e procedurave doganore kanë ndikim të drejtpërdrejtë në lehtësimin e ngarkesave administrative për bizneset, duke e bërë tregtinë më efikase dhe më tërheqëse për investitorët.

Këto përpjekje janë thelbësore për rritjen ekonomike dhe përmirësimin e klimës së biznesit, duke kontribuar në një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e tregtisë dhe investimeve. Doganat do të vazhdojnë të përqendrohen në këto masa për të siguruar që proceset doganore të jenë sa më të lehta dhe të efektshme për të gjithë pjesëmarrësit në tregtinë ndërkombëtare.

Llojet e lirimeve	Janar-Dhjetor 2023 Taksat e liruara mil.€	Janar-Dhjetor 2022 Taksat e liruara mil.€	Përqindja %
Lirimet Pako Fiskale	152,28	151,58	+0.47%
MSA	134,93	118,08	+14.27%
MTL me Turqi	48,62	31,48	+54.45%
Total lirimet	335,83	301,14	+ 11.52%

Tabela e lirimeve nga taksat Janar-Dhjetor 2023/2022

3. ZHVILLIMI I SISTEMEVE DHE PROCEDURAVE

Dogana ka përmirësuar dhe avancuar ndjeshëm sistemet e saj, duke synuar që proceset e punës, si brenda doganës ashtu edhe nga palët e interesit, të jenë më të qasshme për qytetarët dhe bizneset. Këto përpjekje janë bërë për të rritur efikasitetin dhe transparencën, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për të gjithë përdoruesit e shërbimeve doganore.

Zhvillimet Kryesore të Sistemit të Brendshëm:

Gjatë vitit 2023 janë realizuar përmirësime të mëdha në sistemin e brendshëm që menaxhon stafin brenda Doganës. Ky sistem është pasuruar me module të reja që kanë sjellë një sërë përfitimesh dhe përmirësimesh në operacionet e përditshme.

Përmirësimet dhe Furnizimet Kryesore:

- **Sistemi Softuerik i Doganave të Kosovës sipas Standardeve Ndërkombëtare:** Përmirësimi i sistemit softuerik për të përmbushur standardet ndërkombëtare, duke rritur efikasitetin dhe sigurinë e operacioneve doganore.
- **Furnizim me Licenca për AW, BI, Oracle Software, Red-Hat, Linux, Antivirus, etj. (3 vjeçare):** Sigurimi i licencave për softuerët e nevojshëm për funksionimin e përditshëm të Doganës, duke garantuar stabilitet dhe mbrojtje të të dhënave.
- **Furnizim me Harduer për Asycuda, Law Enforcement dhe Pajisje të tjera IT:** Përmirësimi i infrastrukturës harduerike për sistemin Asycuda dhe pajisjet për zbatimin e ligjit, duke rritur kapacitetet dhe efikasitetin e këtyre sistemeve.
- **Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative (Infrastruktura e Rrjetit):** Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit për të siguruar një lidhje të qëndrueshme dhe të shpejtë për të gjithë përdoruesit e sistemit.
- **Sistemi për Menaxhimin e Përmbajtjes:** Implementimi i një sistemi për menaxhimin e përmbajtjes, duke lehtësuar administrimin dhe organizimin e dokumenteve dhe informacionit të rëndësishëm.

Këto zhvillime dhe përmirësime janë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Doganës për të ofruar shërbime më të mira dhe më të efektshme për qytetarët dhe bizneset. Investimet në teknologji dhe infrastrukturë janë një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të operacioneve doganore dhe përmbushjes së standardeve ndërkombëtare.

Zhvillimi i Stafit dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar në Dogana

Dogana ka bërë përpjekje të mëdha për zhvillimin e stafit të saj përmes trajnimeve në fusha profesionale dhe bashkëpunimeve me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Këto përpjekje kanë kontribuar në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të zyrtarëve doganorë, duke rritur efektivitetin e operacioneve doganore dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare.

Aktivitetet Trajnuese dhe Zhvillimore

- **Periodha raportuese** shënon realizimin e gjithsej **98 aktiviteteve trajnuese zhvillimore**, në **94 fusha të ndryshme profesionale, menaxhuese dhe teknike**.
- **448 Oficerë dhe Zyrtarë Doganorë** janë trajnuar/zhvilluar, në kuadër të aktiviteteve të brendshme dhe të jashtme të Doganës.
- **Spektri i gjerë i partnerëve bashkëpunues dhe përkrahës** ka përfshirë: IKAP, EXBS, AKSP, CEPOL, CLDP, MFPT, OSBE, WCO, UNODC, PECK, KP, etj.

Identifikimi dhe Planifikimi i Nevojave Trajnuese

- Procesi i identifikimit të nevojave trajnuese në nivel të drejtorive për plotësim dhe azhurnim të KPAT 2024-2026 dhe hartimi i planit vjetor të trajnimeve për vitin 2024 **nuk është realizuar ende**, për shkak të mungesës së informacioneve kthyesve nga drejtorët e drejtorive.
- **Aranzhim-zhvillimi i trajnimeve të brendshme** bazuar në Kalendarin e Trajnimeve për vitin 2023 ka arritur të zhvillojë gjithsej **16 aktivitete trajnuese**, ndërsa 16 të tjera nuk janë realizuar sipas planifikimit për shkak të mungesës së përcaktimit të stafit nga udhëheqësit e tyre.

Trajnime të Paplanifikuara

- Janë mbajtur edhe dy trajnime të paplanifikuara, me temën "Sanksionet Ndërkombëtare me fokus tek sanksionet e BE-së ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë", të cilat janë identifikuar gjatë vitit si të nevojshme.

Përpjekjet e Doganës për të zhvilluar stafin përmes trajnimeve dhe bashkëpunimeve kanë qenë të suksesshme dhe kanë sjellë përfitime të dukshme. Përmirësimi i vazhdueshëm i aftësive të zyrtarëve doganorë mbetet një prioritet për të arritur objektivat strategjike dhe për të siguruar një shërbim më të efektshëm dhe profesional.

4. LEGJISLACIONI

Ne aspektin e legjislacionit gjatë këtij viti raportues, në zbatim të planit strategjik dhe atij të veprimit, në kuadër të kompetencave ligjore dhe detyrave Dogana ka treguar një performancë të kënaqshme të punës dhe profesionalizëm të lartë. Ky sukses është reflektuar në disa fusha kyçe:

- **Trajtimi i Ankesave:** DL ka trajtuar me efektivitet dhe profesionalizëm ankesat e subjekteve ndaj vendimeve të DK-së, duke siguruar transparencë dhe drejtësi në çdo vendim të marrë.
- **Opinione Ligjore:** Dhënia e opinioneve ligjore të sakta dhe të mbështetura në ligj ka ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve komplekse dhe në drejtimin e saktë të veprimtarive administrative.
- **Draftimi i Aktit Ligjor:** DL ka draftuar akte të ndryshme ligjore, duke përfshirë rregullore dhe udhëzime që ndihmojnë në përmirësimin e kuadrit ligjor të DK-së.
- **Zbatimi i Planit Legjislativ (PL):** është zbatuar me sukses planin legjislativ të QRK-së dhe DK-së për vitin 2023, duke siguruar përputhshmëri me standardet ligjore dhe administrative.
- **Përfaqësimi në Konteste:** DL ka përfaqësuar DK-në në konteste të ndryshme administrative, civile dhe penale, duke mbrojtur interesat e institucionit me profesionalizëm.

Bashkëpunim Ndërinstitucional: DL ka zhvilluar një bashkëpunim të mirë me institucione dhe ministri të tjera të QRK-së. Përveç përfaqësimit të DK-së në grupet punuese për realizimin e PL-së, DL ka bashkëpunuar në draftimin e interpretimeve ligjore të cilat ndërlidhen me ligje apo vendime qeveritare jashtë fushës së veprimtarisë doganore, për të cilat DK, sipas rregullores për fushat e përgjegjësisë, nuk ka përgjegjësinë direkte për interpretime të akteve ligjore.

Draftimi i Projektligjit për Kodin e Ri Doganor dhe të Akcizave: Gjatë këtij viti raportues, DL ka qenë aktiv në përfundimin e draftimit të projektligjit për Kodin e ri Doganor dhe të Akcizave. Ky projektligj, pas miratimit nga QRK-ja, ka kaluar fazën e miratimit në parim në Kuvendin e Republikës së Kosovës më datë 02.11.2023 dhe pritet të miratohet në pjesën e parë të vitit 2024.

Derisa departamente brenda Dogane kane operuar si në vijim:

Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve (SRV)

Gjatë vitit 2023, janë pranuar një total prej 1142 lëndëve, përfshirë 1113 ankesa të rregullta dhe 29 lëndë të kthyer në rivendosje nga Gjykata Komeriale. Kjo përfaqëson një rritje prej 199 ankesash të rregullta krahasuar me vitin 2022, një rritje e ndikuar kryesisht nga

kontestet e vlerës. Ndërkohë, kemi pasur një ulje prej 64 lëndësh të kthyer në rivendosje nga Gjykata Themelore. Jane përfunduar 1063 lëndë të rregullta dhe 28 lëndë të kthyer në rivendosje, duke përmbyllur gjithsej 1091 lëndë. Aktualisht, në procedurë kanë mbetur 104 lëndë, nga të cilat 11 janë të pezulluara në pritje të përgjigjeve nga sektorë të tjerë profesionalë. Kërkesat për rivlerësim të mallit vazhdojnë të dominojnë, përbërëse të mbi 70% të ankesave totale, ndërsa mbi 75% e lëndëve të përfunduara janë refuzuar.

Spektori për Këshilla dhe Procedura (SKP)

Jane draftuar 301 këshilla ligjore për subjekte dhe strukturat e DK-së. Stafi i sektorit ka qenë vazhdimisht i angazhuar në grupe të ndryshme punuese brenda DK-së dhe në institucione të tjera qeveritare. Në zbatim të planit legjislativ të QRK-së për vitin 2023, SKP ka kontribuar në draftimin e Kodit Doganor dhe Akcizave, projektligjin për aderim në Konventën e Stambollit, si dhe në legjislacionin tjetër të sponsorizuar nga ministritë tjera.

Gjithashtu, në zbatim të planit legjislativ të MFPT-së dhe DK-së, janë draftuar udhëzime administrative në zbatim të KDA-së dhe ligjeve të tjera nga fusha e veprimtarisë së MFPT-së.

Spektori i Përfaqësimeve (SP)

Gjatë vitit 2023, zyrtarët e Doganes kanë marrë pjesë në 526 seanca gjyqësore të niveleve dhe kompetencave të ndryshme. Janë parashtruar 82 ankesa në Gjykatën e Apelit dhe 5 ankesa në Gjykatën Supreme. Tek përmbartuesi janë dërguar 121 lëndë me një vlerë totale prej 1,163,565.53 €, nga të cilat janë inkasuar 326,036.40 €. Bazuar në vendimet e Gjykatave, janë kthyer 599,533.97 €, që përfaqëson një rritje prej 36,605.14 € krahasuar me vitin e kaluar.

Gjatë vitit raportues, janë pranuar 73 aktgjykime nga Gjykata Themelore, ku subjektet paditëse janë refuzuar në 73 raste dhe janë aprovuar në 26 raste.

SP ka vazhduar të sigurojë përfaqësim profesional dhe brenda afateve ligjore, duke bashkëpunuar me sektorë të tjerë për rastet komplekse, si Tarifa, Hetuesia, dhe SKPI.

Departamenti Ligjor ka treguar një përkushtim dhe profesionalizëm të lartë gjatë vitit 2023, duke përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë me efikasitet dhe duke kontribuar në përmirësimin e procedurave dhe kuadrit ligjor të DK-së. Performanca e lartë në trajtimin e ankesave, dhënien e këshillave ligjore, përfaqësimin në gjykata dhe draftimin e legjislacionit është dëshmi i angazhimit të vazhdueshëm për të siguruar një mjedis ligjor të drejtë dhe efikas. Këto arritje dhe bashkëpunimi efektiv me institucionet e tjera do të vazhdojnë të jenë prioritetet kyçe në vitet e ardhshme.

	2022	2023	Përqindja +/-
Ankesa te pranuar (rregullta dhe Gjykatës ne rivendosje)	914+93	1113+29	+13%
Ankesa te përfunduara	990+119	1063+28	-2%
Ankesa te mbetura ne procedure	58	104	+79%
Vlera e kontestit te lendeve	7,008,855.61€	9,353,565.34 €	+33%
Shuma e mjeteve te aprovuara/kthjera	357,877.68 €	409,673.20 €	+14%
Kërkesa për këshilla ligjore	423	301	-28%
Pjesëmarrje ne GP	168	60	+64%
Akte ligjore/nënligjore te fuqizuara	14	5	-66%

5. ZBATIMIT I LIGJIT

Dogana e Kosovës ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve për të përmbushur objektivat e saj strategjike në parandalimin e kontrabandës, korrupsionit dhe ekonomisë joformale. Në fushën e aktiviteteve të zbatimit të ligjit, Dogana e Kosovës ka ndërmarrë një sërë iniciativash të vazhdueshme për të parandaluar kontrabandën e mallrave dhe dukuritë e tjera negative. Për të arritur këto objektiva, Njësitet Antikontrabandë kanë qenë në vijën e parë të përpjekjeve tona dhe kanë arritur rezultate të jashtëzakonshme. Ja disa nga arritjet tona kryesore:

Kontrolle dhe Ndalesa Rrugore: Janë kryer gjithsej 3303 ndalesa rrugore dhe 7896 kontrolle në vendkalime kufitare. Këto operacione kanë qenë të suksesshme në zbulimin dhe parandalimin e një numri të madh të rasteve të kontrabandës.

Pjesëmarrje në Plane Operative: Njësitet tona kanë marrë pjesë në 125 plane operative në bashkëpunim me agjenci të tjera të zbatimit të ligjit. Këto operacione të përbashkëta kanë qenë vendimtare për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e përpjekjeve tona për zbatimin e ligjit.

Asistencë për Sektorët e Tjerë: Në 245 raste, Njësitet Antikontrabandë kanë ofruar asistencë për sektorët e tjerë brenda Doganës. Ky bashkëpunim i ngushtë ka ndihmuar në zbulimin dhe trajtimin e një numri të madh të rasteve të kundërvajtjeve doganore.

Zbulimi i Kundërvajtjeve Doganore: Si rezultat i këtyre aktiviteteve, janë zbuluar 478 kundërvajtje doganore. Këto kundërvajtje përfshijnë një gamë të gjerë të aktiviteteve ilegale që janë parandaluar dhe trajtuar në mënyrë efektive.

Konfiskimi i Mallrave të Kontrabanduara: Është konfiskuar mall i kontrabanduar në vlerë prej rreth 3,661,652.00 €. Kjo vlerë e lartë e mallrave të konfiskuara reflekton përpjekjet tona të vazhdueshme dhe të suksesshme për të mbrojtur ekonominë dhe sigurinë e Kosovës nga aktivitetet ilegale.

Derisa përmes strukturave të brendshme të doganës gjithashtu është arritur që të kemi:

- **Kontrolla:** Janë kryer 59 kontrolle të rregullta dhe 122 kontrolle të papritura. Si rezultat, janë lëshuar 79 aktvendime për inkasim me një vlerë totale prej 5,903,326.05 €.
- **Inspektimi paszhdoganimit:** Janë inspektuar 34,143 lëndë dhe janë rivlerësuar 581 prej tyre, duke rezultuar në një vlerë prej 210,254.63 €.

-

	2022	2023	Diferenca
Numri i Kontrollave	156	181	13.8 %
Numri i Aktvendimeve	100	79	-26.5 %
Vlera e Aktvendimeve per Inkasim	4,698,218.36 €	5,903,326.05	+ 22.03 %

Për secilin sektor të specializuar të Doganës që ka arritur rezultate të mira gjatë vitit 2023, po paraqiten detajet e arritjeve:

Sektori i së Drejtës për Pronësi Intelektuale (DPI)

- **Verifikimi dhe Konfiskimi:**
 - Janë verifikuar 689 raste në total, ku janë ndaluar për verifikim 3,393,538 artikuj.
 - Është konfiskuar mall i falsifikuar me një vlerë totale prej 13,054,882.00 €.
 - Janë asgjësuar 276,983 artikuj me një vlerë prej 10,533,111.00 €.

Ky sektor ka operuar me efikasitet për të zbatuar ligjin dhe mbrojtur pronën intelektuale, duke ndikuar në reduktimin e shpërdorimit të markave dhe produktit të falsifikuar në tregun e Kosovës. Këto veprime tregojnë përkushtimin e Doganës për të mbrojtur të drejtat e pronësisë intelektuale dhe për të siguruar që tregu të funksionojë në përputhje me ligjet dhe standardet ndërkombëtare.

Dogana, nëpërmjet hetimeve të saj, ka arritur rezultate të rëndësishme gjatë vitit 2023. Këtu janë detajet e arritjeve të regjistruara në këtë sektor:

Sektori i Hetimeve

- **Numri i Rasteve dhe Kallëzimeve Penale:**
 - Janë regjistruar 114 raste të reja për hetim nga Dogana.
 - Dogana ka dorëzuar 92 kallëzime penale pranë prokurorive përgjegjëse.
- **Shmangia nga Detyrimet Doganore:**
 - Për 92 prej këtyre rasteve janë siguruar prova të mjaftueshme që dëshmojnë shmangie nga detyrimet doganore në vlerë prej 2,325,984.91 €.
- **Sekuestrimi i Mallrave:**
 - Janë sekuestruar mallra në vlerë prej 1,868,951.67 Euro në kuadër të këtyre hetimeve.
- **Aksione kundër kontrabandës dhe shmangies nga tatimet:**
 - Janë intervistuar 163 persona të dyshuar në lidhje me veprimet e kontrabandës dhe shmangies nga tatimet.

- Me urdhër të organeve kompetente, janë arrestuar 14 persona për veprime të dyshimta në lidhje me kontrabandën dhe shmangien nga tatimet e detyrueshme.

	Viti 2022	Viti 2023	Përqindja +/-
Aktiviteti	2022	2023	%
Ndalesa Rrugore AK	3017	3303	+9.47%
Kontrolla ne PKK AK	7433	7896	+6.22%
Plane Operative me Agjencione te tjera AK	92	125	+35.86
Kundërvajtje te AK	282	478	+69.50%
Vlera e mallit te Zbuluar AK	1,840,816.00	3,661,652.00	+98.91%
Numri i Kontrollave KP	156	181	+16.02
Numri i Aktvendimeve KP	100	79	+12.58
Vlera e Aktvendimeve për Inkasim KP	4,698,218.36	5,903,326.05	+25.65%
Numri i Deklaratave te Inspektuara IPZH	39416	34143	-13.37%
Rivlerësime Pas zhdoganimit IPZH	457	581	+27.13%
Shuma e Rivlerësuar IPZH	357,261.41	210,254.63	-41.14%
Raste te Verifikuara DPI	612	689	+12.58%
Artikuj te Verifikuar DPI	968,980	3,393,538	+250.21%
Vlera e Mallit te Konfiskuar DPI	8,851,015.00	13,054,882.00	+47.49%
Numri i Artikujve te Asgjësuar DPI	213,061	276,983	+30.00%
Vlera e Mallit te Asgjësuar DPI	7,717,183.00	10,533,111.00	+36.48%
Raste te reja nen Hetime / Hetime	91	114	+25.27%
Kallëzime Penale / Hetime	69	92	+33.33%
Vlera e Shmangieve te argumentuara / Hetime	2,873,093.20	2,325,984.91	-19.04%
Vlera e mallit te Sekuestruar / Hetime	1,868,951.67	1,150,032.53	-38.46%
Numri i Personave te Intervistuar / Hetime	201	163	-18.90%
Numri i personave te Arrestuar / Hetime	16	14	-12.50%
Numri i Kundërvajtjeve te Trajtuara / Kundërvajtje	1783	1922	+7.79%
Vlera e mallit ne Kundërvajtje / Kundërvajtje	6,258,497.98	8,954,833.15	+43.08%
Vlera e Gjobave te Shqiptuara / Kundërvajtje	1,852,666.00	2,435,579.00	+33.46%
Vlera e mallit te Konfiskuar / Kundërvajtje	657,299.86	1,186,684.45	+80.53%
Numri i Shenjëstrimeve / Analiza e Riskut	598	428	-28.42%
Numri i Profileve te Reja te riskut te krijuara / Analiza e Riskut	151	142	-5.96%
Numri i Profileve te Modifikuara / Analiza e Riskut	121	105	+13.22%
Subjekte të azhurnuar në lista të selektivitetit / Analiza e Riskut	3141	6594	+109.93%
Kundërvajtje si rezultat i profileve te Riskut / Analiza e Riskut	559	831	+48.65%
Vlera e ngritur (Uplift Value)/€ / / Analiza e Riskut	83,265,926.36	114,285,125.25	+37.25%

6 AKCIZA

Gjatë vitit 2023, Dogana ka përmirësuar dhe zgjeruar aktivitetet e saj, duke arritur me sukses të plotësojë detyrat e përcaktuara, edhe pse është përballur me sfida të mungesës së theksuar të stafit. Këtu janë disa nga arritjet kryesore:

Dogana ka ndërmarrë masa për të përmirësuar dhe zgjeruar aktivitetet e saj në të gjitha nivelet. Përshembull, ka rritur numrin e kontrollit të mallrave, ndalesave rrugore dhe kontrollit në vendkalime kufitare për të parandaluar kontrabandën dhe dukuritë e tjera negative.

Edhe pse ka pasur sfida me mungesën e stafit, Dogana ka qenë në gjendje të përmbushë detyrat e planifikuara me sukses. Kjo ka përfshirë përpunimin e rasteve të reja për hetim, zbatimin e detyrave ligjore dhe mbështetjen e sektorëve të tjerë të administratës doganore. Në përgjithësi, Dogana ka arritur që të përmbushë objektivat strategjike të vendosura për vitin 2023. Kjo përfshinë përmirësimin e efikasitetit operacional dhe zbatimin e ligjeve doganore në mënyrë të efektshme.

	Viti 2022	Viti 2023	Përqindja +/-
Akciza në import të duhanit	213,826,528.40 €	224,676,425.40 €	+5.074%
Akciza e brendshme në duhan	369,655.70 €	203,769.15 €	-55.28%
Akciza në pijet alkoolike	5,374,830.56 €	5,159,194.58 €	-4.179%
Akciza në pijet joalkoolike	651,844.69 €	756,359.00 €	+16.03%
Taksat e pezulluara tek Depot Doganore	27,040,022.66	35,107,039.73	+29.8%
Taksat e pezulluara tek PA	3,715,157.68	2,990,971.26	-19.5%

Te hyrat nga produktet akcizore krahasim 2022/2023

7. LUFTIMI I KORRUPSIONIT

Dogana e Kosovës, përmes Sektorit për Standarde Profesionale, siguron që të gjithë zyrtarët e saj gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare të jenë në nivelin më të lartë të përgjegjësisë dhe të respektojnë Kodin e Sjelljes. Ky sektor monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e drejtë të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera në fuqi nga të gjitha nivelet qeveritare dhe lokale. Bashkëpunimi i Sektorit për Standarde Profesionale shtrihet në të gjitha njësitë organizative të Doganës, duke marrë masa parandaluese dhe hetimore për shkelje disiplinore në përputhje me ligjin dhe rregullat e brendshme të Doganës së Kosovës, si dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit të Doganës së Kosovës.

Gjatë vitit 2023, ekipi i SSP ka realizuar një sërë veprimesh dhe ka përfunduar raste disiplinore në mënyrë të detajuar si vijon:

- **Informata të pranuar gjatë 2023:** 5 informata të reja janë pranuar gjatë vitit 2023.
- **Informata të proceduara gjatë vitit (përfshirë disa të pranuar në vitin 2022):** Në total janë procesuar 8 informata gjatë vitit 2023.
- **Raste disiplinore të iniciuara në SSP gjatë vitit 2023:** Janë nisur 9 raste disiplinore në vitin 2023. Këto përfshijnë:
 - 2 raste për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga 8 zyrtarë,
 - 1 rast për neglizhencë,
 - 2 raste për sjellje të pahijshme,
 - 4 raste të tjera.
- **Raste disiplinore të përfunduara në periudhën raportuese (përfshirë nga vitet paraprake):** Një total prej 10 raste disiplinore janë përfunduar gjatë vitit 2023.
- **Raste të shqyrtuara në Komision Disiplinor:** Janë shqyrtuar 5 raste në Komisionin Disiplinor gjatë vitit 2023.
- **Raste në procedurë:** Aktualisht janë në procedurë 4 raste, me 11 zyrtarë të përfshirë në këto procedura.
- **Masa disiplinore të shqiptuara:** Gjatë vitit 2023, janë shqiptuar në total 10 masa disiplinore. Këto përfshijnë:
 - Suspendime: 9,
 - Ndërprerje e marrëdhënies së punës: 1,
 - Para përjashtim dhe Transfer: 1,
 - Dënime financiare: 5,
 - Vërejtje verbale: 3.

Masa disiplinore janë aplikuar në përputhje me rregulloret dhe janë proporcionale me numrin e zyrtarëve të dënuar. Këto veprime tregojnë angazhimin e SSP në menaxhimin e rasteve disiplinore dhe mbrojtjen e integritetit institucional gjatë vitit 2023.

Periudha	Viti 2022	Viti 2023	
Suspendime	4	9	+5%
Suspendime te bartura nga viti paraprak	9	3	+23%
Para përjashtim dhe Transfer disiplinor	0	1	-10%
Dënime Financiare	12	5	+6%
Degradim	0	0	-24%
Ndërprerje e marrëdhënies së punës	12	1	+31%
Vërejtje verbale	0	3	+248%
Vërejtje me shkrim	1	0	
Ndalim avancimi	0	0	
Totali	25	18	

8. BUXHETI DHE FINANCAT

Bazuar në Ligjin nr. 08/L-193 "Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023", Doganës i janë ndarë fonde sipas kategorive të shpenzimeve të paraqitura në tabelën e mëposhtme. Më datën 24 maj 2023, nga MFPT janë alokuar 16,591.80 euro në emër të fondit të Unionit European për Doganën, sipas përshkrimit "Dogana 2020", në kategorinë e shpenzimit për mallra dhe shërbime (49/201/13300/13/92104). Këto fonde kanë përfshirë rritjen buxhetore nga buxheti i aprovuar për vitin 2023.

Kodi ekonomik	Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti i aprovuar për vitin 2023	Buxheti i aprovuar për Maj 2023	Buxheti i aprovuar Nëntor 2023	Buxheti i aprovuar Dhjetor 2023
11100	Paga dhe Mëditje	6,239,173.00	6,239,173.00	6,239,173.00	6,261,500.88
13000	Mallra dhe Shërbime	5,014,862.00	5,014,862.00	4,134,862.00	4,134,862.00
13200	Shpenzime Komunale	469,375.00	469,375.00	469,375.00	124,375.00
03000	Shpenzimet Kapitale	8,602,000.00	8,602,000.00	8,378,105.00	4,378,106.00
	Totali	20,325,410.00	20,325,410.00	19,221,515.82	14,898,843.88
13000 49 EU – UNIONI EUROPIAN	Mallra dhe Shërbime - Donacion	0.00	16,591.80	16,591.80	16,591.80
	Totali i Përgjithshëm	20,325,410.00	20,342,001.80	19,238,107.62	14,915,435.68

Shpenzimet buxhetore të Doganës së Kosovës

9. OPERACIONET E VEÇANTA KUNDËR KONTRABANDËS

- Me 11/01/2023 ne Fushe Kosove Oficeret Doganor te DZL-se kane kryer një kontrollë te një Kompani Importuese dhe me këtë rast është hasur ne mall pa dokumentacion e qe besohet se është kontrabanduar ne vlere prej 9,540.00 Euro.
- Me 19/01/2023 ne Suhareke është kontrolluar një Kompani e cila ka prodhuar Pije Alkoolike pa autorizim dhe me këtë rast janë sekuestruar 2984 Litra Pije Alkoolike me vlere prej 10,397.00 Euro dhe shmangiet nga Detyrimet Doganore janë 13,965.00 Euro.
- Me 23/01/2023 Ne PKK Hani i Elezit gjate kontrolles detaje ne një automjet janë gjetur mallra te fshehura ete padeklaruara (118 cope Parfuma te ndryshëm) ne vlere prej 5,239.00 Euro.
- Me 28/01/2023 ne Prishtine është Kontrolluar një Kompani qe merret me shitjen e Telefonave Mobil / Mobil Shop dhe me këtë rast janë gjetura dhe sekuestruar 35 telefona celular me vlere prej 15,466.00 Euro.
- Me 29/01/2023 zyrtaret e Drejtorisë se Zbatimit te Ligjit kane ndaluar per kontrollë një automjet transportues dhe me këtë rast janë gjetur te fshehura ne rezervuare 107.5 Kg Marihuane ne vlere prej 215.000.00 Euro.
- Me 04/02/2023 ne Prishtine, Oficeret Doganor te DZL-se kane kryer një kontrollë neper Dyqane qe merren me shitje te Cigareve (Free Shop) dhe me kete rast ne dy prej tyre është gjeture një sasi e Cigareve te kontrabanduara si dhe Cigare Heets, Malli është konfiskuar dhe lendet janë referuar per procedure kundërvajtëse.
- Me 06/02/2023 ne Prishtine, Oficeret e Sektorit Antikontrabande kane organizuar Pika Statike per Kontrolla detaje dhe me këtë rast janë gjetur 6 automjete me targa te Huaja e te pazhdoganuara qe kane qene ne qarkullim ne kundërshtim me legjislacionin ne Fuqi. Automjetet janë sekuestruar dhe janë iniciuar procedurat kundërvajtëse.
- Me 09/02/2023 ne Prishtine Oficeret Doganor te DZL-se kane kryer një kontrollë te një Kompani Importuese "Hako Kosova" dhe me këtë rast është hasur ne 5

automjete transportuese te Punës qe i kane përdorur per shpërndarjen e mallit e qe nuk kane qene te zhdoganuara apo ne ndonjë procedure tjetër Doganore, prandaj automjetet ne vlere prej 110,820.00 Euro janë Sekuestruar.

- Me 15/02/2023 Oficeret e Sektorit Antikontrabande kane kontrolluar detajisht një ngarkesë me Tekstil nga Turqia me dhe këtë rast është gjetur mall i padeklaruar ne vlere prej 8,990.00 Euro. Malli është konfiskuar dhe lënda është trajtuar ne Procedure Kundërvajtëse.
- Me 22/02/2023 Oficeret e Sektorit Antikontrabande kane kontrolluar detajisht edhe një ngarkesë me Tekstil nga Turqia me dhe këtë rast është gjetur mall i padeklaruar ne vlere prej 7,175.00 Euro. Malli është konfiskuar dhe lënda është trajtuar ne Procedure Kundërvajtëse.
- Me 24/02/2023 ne Mazgit Oficeret Doganor te DZL-se kane kryer një kontrolle te një Kompani Importuese "CFO Farma" dhe me këtë rast është hasur ne 8 automjete transportuese te Punës qe i kane përdorur per shpërndarjen e mallit e qe nuk kane qene te zhdoganuara apo ne ndonjë procedure tjetër Doganore, prandaj automjetet ne vlere prej 50,630.00 Euro janë Sekuestruar.
- Me 25/02/2023 ne Prishtine, Oficeret e Sektorit Antikontrabande kane organizuar Pika Statike per Kontrolla detaje dhe me këtë rast janë gjetur 4 automjete me targa te Huaja e te pazhdoganuara qe kane qene ne qarkullim ne kundërshtim me legjislacionin ne Fuqi. Automjetet janë sekuestruar dhe janë iniciuar procedurat kundërvajtëse.
- Me 02/03/2023 ne Zyrtaret e DZL-se kane asistuar Policinë e Kosovës ne Bastisje te disa Lokacioneve te dyshimta dhe Auto salloneve dhe me këtë rast janë gjetur 14 automjete te Pazhdoganuara te cilat pas koordinimit me Prokurorinë janë trajtuar ne Procedurë Kundërvajtjeje.
- Me 02/03/2023 ne Gjilan, Njësitet Antikontrabande kane organizuar një kontrolle te një Dyqani / Mobil Shop dhe me këtë rast janë gjetur dhe sekuestruar 28 telefona te Kontrabanduar.
- Me 08/03/2023 ne Suhareke, Drejtoria e Zbatimit te Ligjit ka organizuar kontrolle ne dy lokacione ku me këtë rast janë sekuestruar 33,850 Litra Pije Alkoolike (Vere dhe Raki) te prodhuar pautorizim.

- Me 15/03/2023 ne Gjakove, Njësitet Antikontrabande kane organizuar një kontrollë të një Dyqani / Mobil Shop dhe me këtë rast janë gjetur dhe sekuestruar 29 telefona të Kontrabanduar.
- Me 17/03/2023 ne Peje, Njësitet Antikontrabande së bashku me Policinë e Kosovës kane kryer kontrollën të disa Lokacioneve të dyshimta dhe me këtë rast janë gjetur dhe sekuestruar 58 telefona të Kontrabanduar.
- Me 21/03/2023 ne Prishtinë, Njësitet Antikontrabande kane organizuar një Kontrollë në një kompani dhe me këtë rast është gjetur dhe sekuestruar një sasi e konsiderueshme e Tekstilit të Kontrabanduar (Vlera mbi 10,000.00 Euro).
- Me 22/03/2023 ne Peje, Njësitet Antikontrabande së bashku me Policinë e Kosovës kane kryer kontrollën të disa Barnatoreve dhe me këtë rast është gjetur dhe sekuestruar një sasi e konsiderueshme e barnave të kontrabanduara.
- Me 27/03/2023 ne Viti, Drejtoria e Zbatimit të Ligjit në koordinim me Policinë e Kosovës pas një hetimi të përbashkët, kane organizuar një kontrollë në një lokacion të dyshimtë dhe me këtë rast është gjetur Duhan dhe Cigare të Kontrabanduara e ku dyshohet se është bërë edhe Përpunimi dhe grirja e Gjetheve të Duhanit. Me këtë rast janë sekuestruar 897 Kg Duhan dhe 250,000 Cope Cigare si dhe dy linja për përpunim të duhanit dhe janë arrestuar 5 të dyshuar. Shmangiet e llogaritura nga Taksat e Aplikueshme doganore janë 66,935.00 Euro.
- Me 04/04/2023 ne Gjilan, Njësitet Antikontrabande kane organizuar një kontrollë të një Dyqani / Mobil Shop dhe me këtë rast janë gjetur dhe sekuestruar 27 telefona të Kontrabanduar.
- Me 06/04/2023 në tregun me Shumice në Prishtinë, Zyrtaret e DZL-se kane kryer një kontrollë në dy lokacione dhe me këtë rast është hasur në 5900 kg Qepe të kontrabanduara me Origjinë nga Rusia.
- Me 07/04/2023 në Prizren, së bashku me Policinë e Kosovës / krimet Ekonomike janë kontrolluar 7 Barnatore dhe me këtë rast është hasur në një sasi të theksuar të barna të kontrabanduara dhe pa banderolë të RKS.
- Me 12/04/2023 në Gjilan, Njësitet Antikontrabande kane kryer kontrollë në një barnatore dhe është hasur në barna të kontrabanduara pa banderolë të RKS.
- Gjatë muajit Prill së bashku me Policinë e Kosovës / Drejtorinë e Mitrovicës së Veriut janë ndërmarrë aksione të përbashkëta ku në 5 Lokacione janë sekuestruar

Pajisje teknologjike per Prodhim te Kriptoalutave. Rastet janë trajtuar nga Dogana ne Procedure Administrative Kundervajtese.

- Me 02/05/2023 ne PKK Vermice, Njësitet Antikontrabande kane selektuar per kontrole një veture te dyshimte dhe me këtë rast është hasur ne një sasi e vogël e lendes narkotike per përdorim personal, pjese per Armen (Kondak dhe Dylbi) si dhe dokumente te falsifikuar. Rasti i është dorëzuar policisë per trajtim te mëtejshëm.
- Me 06/05/2023 ne PKK Vermice, Njësitet Antikikontrabande ne kuadër te operacionit te përbashkët me Shqipërinë gjate kontroles detaje te nje veture kane hasur ne 150 Gr Kokainë. Rasti i është dorëzuar Policisë se Kosovës per trajtim te mëtejshëm.
- Me 09/05/2023 ne PKK Vermice, Njësitet Antikikontrabande ne kuadër te operacionit “Klaudius” te organizuar nga HMRC gjate kontroles detaje te një veture kane hasur ne 22.8kg Duhan te grire.
- Me 12/05/2023 ne Mitrovice Veri, Njësitet Antikontrabande se bashku me Policinë e Kosovës kane organizuar një kontrole ne dy lokale ku është hasur ne 2304 litra Pije Coca Cola dhe Fanta, 2160 Cope Çokollata, 40,000 Cope Filtëra te Cigareve dhe 230 kg Sallame.
- Me 20/05/2023 ne Ferizaj, Njësitet Antikontrabande kane kontrolluar dy barnatore dhe me ketë rast është hasur ne 479 Pako te barnave te Kontrabanduara.
- Me 24/05/2023 ne Prishtine, Njësitet Antikontrabande kane kontrolluar 6 lokale te dyshimta dhe me këtë rast është hasur ne 250 Boksa Cigare HEETS te kontrabanduara.
- Me 01/06/2023 ne Skenderaj, Njësitet Antikontrabande kane kryer një kontrole ne dy barnatore ku është hasur ne një sasi te konsiderueshme te Barnave te kontrabanduara.
- Me 01/06/2023 ne regjionin e Ferizajit, Zyrtaret Doganor kane ushtruar kontrole pa paralajmërim ne dy lokacione dhe me ketë rast është hasur ne 568 litra Tretës / Nitro te Kontrabanduar.
- Me 15/06/2023 ne Gjakove, Njësitet Antikontrabande kane organizuar një kontrole ne një lokal dhe ne ketë rast është gjetur një sasi e konsiderueshme e

Cigareve, cigareve elektronike, dhe produkte e te tjera te Duhanit per te cilën pala nuk posedonte Dokumente e te cilat janë Kontrabanduar ne Kosove.

- Me 15/06/2023 ne orët e hareshme te mëngjesit Zyrtaret Doganore te Drejtorisë Zbatimit te ligjit kane organizuar një plan operativ me qellim te parandalimit te Kontrabandimit te mallrave dhe me këtë rast është zbuluar dhe parandaluar një rast Tentim Kontrabandimi i një Makine Hidraulike per prerje te drunjëve. Me këtë rast malli i dyshuar është Sekuestruar dhe i dyshuari eshët intervistuar dhe ne konsultim me Prokurorin janë autorizuar Veprime Hetimore te mëtejshme.
- Me 15/06/2023 ne magjistralen Ferizaj-Kaqanik ne kuadër te Planit te përbashkët Operativ te Doganës se Kosovës-ATK-Polici është arritur te identifikohet një veture e cila ishte duke transportuar mall me origjine te huaj e per te cilën pala nuk posedonte dokumentacion qe e dëshmon se ky mall ka hyre përmes rrugëve legale ne Kosove (mall i kontrabanduar).
Me këtë rast malli “Pjese per Kitare” është sekuestruar dhe ndaj palës janë inicuar procedurat kundërvajtëse.
- Me 17/06/2023 ne Regjion te Ferizajit, Njësitet Antikontrabande kane arritur te identifikojnë dhe ndalojnë një automjet te dyshuar i cili ishte duke transportuar 339 pale mbathje sportive pa dokumentacion e qe dyshohet se janë kontrabanduar ne Kosove. Malli i dyshuar është sekuestruar ndaj palës janë inicuar procedurat kundërvajtëse.
- Me 16/06/2023 ne Regjion te Vitisë, Njësitet Antikontrabande kane arritur te parandalojnë kontrabandimin e një sasive te Konsiderueshme te Cigareve nga Maqedonia e Veriut. Me këtë rast janë konfiskuar 20,000 cope Cigare.
Per këtë rast është njoftuar Prokuroria dhe i dyshuari është intervistuar dhe janë filluar Hetimet.
- Me 25/06/2023 ne PKK Merdare, Njësitet Antikontrabande ne kuadër te Planit Operativ per Parandalimin e Kontrabandës me Autobusë kane kryer kontrolla detaje dhe me këtë rast janë hasur raste te tentim kontrabandimit te mallrave te ndryshme ne vlere rreth 12,000.00 Euro.
- Me 26/06/2023 ne ZBD Prishtinë, Njësitet Antikontrabande kane selektuar per kontrole detaje një ngarkese Komerciale dhe me këtë rast është hasur ne mos deklarim te sakte te mallit si dhe rrjedhojë e përshkrimit jo te sakte te mallit është konstatuar diferencë ne vlere ne shume prej 44,737.00 Euro dhe shmangie nga taksat ne vlere prej 8,052.66 Euro.

- Me 02/07/2023 ne Aeroport Njësitët Antikontrabande kane zbuluar një rast tentim kontrabandimit të 10 Telefonave Samsung S22 me vlerë rreth 10,000.00 Euro.
- Me 06/07/2023 është kontrolluar një ngarkesë komerciale dhe me këtë rast është hasur në mos deklaram të sakte të mallit në vlerë prej 9,500.00 Euro.
- Me 10/07/2023 ne Prizren është ndaluar një automjet i dyshuar i cili ishte duke transportuar Peshk dhe Karkalec të freskët të kontrabanduar nga Shqipëria.
- Me 13/07/2023 ne Vushtrri është organizuar një kontrollë dhe me këtë rast është hasur në cigare HEETS të kontrabanduara.
- Me 24/07/2023 ne Magjistratën Mitrovicë-Prishtinë janë identifikuar dy ngarkesa me Peme dhe Perime të kontrabanduara nga Serbia. Malli në vlerë prej 15,000.00 Euro është sekuestruar.
- Me 29/07/2023 ne Mitrovicë janë kontrolluar tri Lokacione dhe me këtë rast është hasur në një sasi të konsiderueshme të Cigareve HEETS të kontrabanduara. Malli në vlerë prej 12.000.00 është sekuestruar dhe ndaj palëve janë iniciuar procedurat ligjore.
- Me 10/08/2023 ne Komoran, Njësitët Antikontrabande të Doganës së Kosovës kane organizuar një kontrollë të befasishme në dy barnatore dhe me këtë rast është hasur në një sasi të konsiderueshme të barnave të kontrabanduara. Barnat janë konfiskuar dhe ndaj palëve janë iniciuar procedurat kundervajtëse.
- Me 14/08/2023 ne Prishtinë, Njësitët Antikontrabande kane kryer kontrollat në tri lokacione të dyshimta dhe me këtë rast është hasur në një sasi të konsiderueshme të Cigareve të kontrabanduara dhe cigareve elektronike HEETS.
- Me 17/08/2023 në regjionin e Prizrenit, Zyrtaret Doganor pas pranimit të informatës përmes rrugëve Operative kane organizuar kontrollë në dy lokacione të dyshimta dhe me këtë rast është hasur në 77 Kg Duhan i përpunuar e për të cilën palët nuk posedonin dokumentacion të origjinës / I Kontrabanda në Territorin e Republikës së Kosovës.
- Me 22/08/2023 në Pejë, Njësitët Antikontrabande kane organizuar Kontrollë në një Biznes, dhe me këtë rast nuk është hasur në mallrat e Kontrabanduara, por gjatë kontrollit të Hapësirës së këtij biznesi është gjetur një Arme pa leje / Pistoletë model CZ 99 cal.9x99mm dhe 11 fishek. Rasti i është dorëzuar Policisë së Kosovës.

- Me 27/08/2023 ne Kamenice, Njësitet Antikontrabande kane kryer kontrolla ne dy lokacione te dyshimta dhe me ketë rast është hasur ne një sasi te konsiderueshme te Cigareve te kontrabanduara dhe cigareve elektronike HEETS
- Me 31/08/2023 ne Prishtine, Njësitet Antikontrabande kane kryer kontrolla ne 5 barnatore te dyshimta dhe me ketë rast është hasur ne një sasi te konsiderueshme barnave te kontrabanduara.
- Me 05/09/2023 ne kuadër te planit operativ ne tere Kosovën janë organizuar Ndalesa Rrugore me fokus tek Automjetet e Postave te Shpejta, dhe si rrjedhoje ne tri raste janë gjetur mallra pa prejardhje ne vlere rreth 22,000.00 Euro e te cilat janë kontrabanduar ne Kosove.
- Me 06/09/2023 ne kuadër te planit operativ janë kontrolluar Zyrrat e 6 Postave te shpejta dhe me ketë rast është gjetur mall pa prejardhje dhe vetura me targa te huaja qe i kane përdorur per distribuim te mallit. Vlora e Mallit dhe e veturave te Konfiskuara është rreth 40,000.00 Euro.
- Me 11/09/2023 ne PKK Vermice, Njësitet Antikontrabande ne kuadër te Kontrollave Rutinore ne vijën e dyte kane ndaluar per kontrolle detaje një autobus ne linjën Tirane - Prishtine, dhe me ketë rast është gjetur mall i padeklaruar / Auto pjesë - Instrument Tabela ne vlere prej 6,000.00 Eurove..
- Me 11/09/2023 ne Ferizaj, Njësitet Antikontrabande kane kryer një kontrolle tek një subjekt per dyshime te prezencës se mallrave te kontrabanduara, ku është hasur ne produkte te qajit per dobësim dhe preparate te tjera stimuluese, te cilat janë kontrabanduar ne Kosove. Me ketë rast gjate kontrollit është hasur edhe ne një arme zjarri pa leje. Malli pa dokumentacion është sekuestruar prej njësiteve te Doganës se Kosovës, kurse arma i është dorëzuar Policisë se Kosovës.
- Me 12/09/2023 ne Prishtine, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës kane kryer kontrolla pa paralajmërim tek 5 subjekte me dyshime per prezencë te mallit te kontrabanduar. Me këtë rast është gjetur një sasi e konsiderueshme e Mjeteve te ndryshme Stimuluese Seksuale ne vlere rreth 40,000.00 Eurove, qe është kontrabanduar ne Kosove e një sasi e tyre edhe me afat te skaduar.
- Me 13/09/2023 ne Fushe Kosove, pas Hetimeve Preliminare duke ndjekur konfiskimin e ditëve te mëhershme ne PKK Vermice, Zyrtaret Doganor kane arritur te identifikojnë një Lokacion ne te cilën janë gjetur Pjese Rezerve, Ulëse dhe pjese tjera per Interior te Veturave e per te cilat pala nuk posedonte Dokumente te Origjinës e qe dyshohet se janë te Kontrabanduara ne Kosove. Vlora e mallit te

konfiskuar llogaritet te jete rreth 10,000 Euro, dhe per ketë rast është njoftuar edhe Prokurori Kujdestar nga Prokuroria Themelore ne Prishtine.

- Me 14/09/2023 Dogana e Kosovës me dyshime per prezencë te mallrave te kontrabanduara ka organizuar kontrolla detaje ne 4 subjekte ne Prishtinë, Gjilan, Podujeve dhe Prizren. Me ketë rast janë gjetur 1200 Litra Tretës / Nitro me origjine te huaj dhe pa dokumentacion qe e dëshmon se janë zhdoganuar. Malli i Kontrabanduar është sekuestruar dhe ndaj subjekteve ku është gjetur ky mall janë iniciuar procedurat Kundërvajtëse.
- Me 14/09/2023 ne Prizren, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës kane kryer nje kontrole me dyshime per prezence te mallit te Kontrabanduar te një subjekt qe merret me shitjen e Telefonave. Dhe me ketë rast janë gjetur 19 Telefona pa dokumentacion qe e dëshmon se janë zhdoganuar.
- Me 26/09/2023 ne Gjakove, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne kuadër te planit operativ per luftimin e Kontrabandes dhe formave te tjera te Krimit ka organizuar një kontroll pa paralajmerim te 6 subjekte dhe me ketë rast janë gjetur dhe konfiskuar mallra si ne vijim:
 - 30 Telefona Samsung dhe Iphone,
 - 62 AirPods,
 - 280 Cope Parfume me origjine nga Serbia,
 - 29 Pako qaj per Dobesim,
 - 88 pako te ndryshme te Stimuluesve Seksual.Malli I kontrabanduar është sekuestruar dhe ndaj palëve janë inicuar procedurat kundërvajtëse.
- Me 27/09/2023 ne Ferizaj, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne kuadër te planit operativ per luftimin e Kontrabandes dhe formave te tjera te Krimit kane organizuar një kontroll pa paralajmërim te 6 subjekte dhe me kete rast jane gjetur dhe konfiskuar 39 Telefona Samsung dhe Iphone.
- Me 29/09/2023 ne Prizren, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne kuadër te planit operativ per luftimin e Kontrabandes dhe formave te tjera te Krimit kane organizuar një kontroll pa paralajmërim te 2 subjekte dhe me ketë rast janë gjetur dhe konfiskuar 912 Litra Tretës Nitro.
- Me 04/10/2023 ne Istog, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne kuadër te planit operativ per luftimin e Kontrabandës dhe formave te tjera te Krimit kane organizuar një kontroll pa paralajmërim te një subjekt / Barnatore dhe me ketë rast janë gjetur dhe konfiskuar 282 Paketime te Barnave te ndryshëm pa banderola e qe janë kontrabanduar ne Kosove përmes rrugëve ilegale, me vlere rreth 4,000.00 Euro.

- Me 07/10/2023 ne Autostraden “Ibrahim Rugova”, Njesitet Antikontrabande kane ndaluar një automjet me targa te Republikës se Shqipërisë i cili ishte duke transportuar malle me origjine te huaj e pa dokumentacion, dhe qe eshte kontrabanduar ne Kosove.
- Me 07/10/2023 ne Prizren, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne kuadër te planit operativ per luftimin e Kontrabandës dhe formave te tjera te Krimit kane organizuar një kontroll pa paralajmërim te dy subjekte / Barnatore dhe me këtë rast janë gjetur dhe konfiskuar mbi 400 Paketime te Barnave te ndryshëm me banderola te Serbisë, Turqisë si dhe pa banderola e qe janë kontrabanduar ne Kosove përmes rrugëve ilegale.
- Me 22/10/2023 ne PKK Merdare, ne kuadër te Planit Operativ per luftimin e Kontrabandes dhe Formave te tjera te Krimit Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës kane kryer Kontrolla Detaje te Personave dhe Mjeteve Motorike ne hyrje te Kosovës. Me këtë rast janë zbuluar dhe parandaluar tri raste te tentim kontrabandimit.
 - Rasti i pare: janë zbuluar Barna dhe Steroide
 - Rasti i dyte: janë zbuluar preparate Kimike per dysHEME / Epoksit
 - Rasti i trete: janë zbuluar 10 Telefona Iphone Pro Max 13 dhe 12
- Me 26/10/2023 ne Mitrovice ne kuade rte Planit Operativ per Luftimin e Kontrabande sehste arritur te ndalohet nje ngarkese e kontrabanduar me 23,544 Ambalazhe Shishe per Coca Cola me vlere prej 9,000.00 Euro.
- Me 28/10/2023 ne PKK Vermice, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës kane kryer kontrolla detaje te automjeteve te dyshuara. Dhe me këtë rast ne një Autobus qe qarkullonte ne relacionin Tirane-Prishtine-Shkup është arritur te gjendet malli i fshehur dhe i padeklaruar/Hard Diska per PC dhe Xhama me Dioptri ne vlere rreth 5000.00 Euro.
- Me 01/11/2023 ne PKK Hani i Elezit, Njesitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne kuadër te Planit Operativ per luftimin e Kontrabandes, kane kryer kontrolla detaje te automjeteve te dyshuara ne hyrje te Republikës se Kosovës. Dhe me këtë rast ne një Automjet te Udhëtareve është arritur te gjendet malli i fshehur dhe i padeklaruar/ bizhuteri Argjendi ne sasi prej 3,6 kg e me vlere rreth 5000.00 Euro.
- Me 04/11/2023 ne Mitrovice, Njësitet Antikontrabande kane ndaluar një automjet te dyshimte i cili ishte duke transportuar mall / Filtera per cigare me origjine te huaj e pa dokumentacion, dhe qe janë kontrabanduar ne Kosove.
- Me 10/11/2023 ne PKK Vermice, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne kuadër te planit operativ per luftimin kane selektuar një automjet te

dyshimte per kontrolle dhe me ketë rast janë gjetur 65,000.00 Euro te padeklaruara.

- Me 12/11/2023 ne PKK Dheu i Bardhe, ne kuadër te Planit Operativ per luftimin e Kontrabandes dhe Formave te tjera te Krimet Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës kane kryer Kontrolla Detaje te Personave dhe Mjeteve Motorike ne hyrje te Kosovës. Me ketë rast është zbuluar dhe parandaluar një rast i tentim kontrabandimit te auto pjesëve te fshehura ne Autobusë.
- Me 18/11/2023 pas një hetimi te gjate nen udhëheqjen e prokurorisë Speciale, Sektori i Hetuesisë i përkrahur nga njësitet e tjera te DZL-se ka ekzekutuar urdhërin per bastisje dhe arrestim te 8 zyrtareve Doganor per keqpërdorim te detyrës zyrtare.
- Me 23/11/2023 ne PKK Dheu i Bardhe, ne kuadër te Planit Operativ per luftimin e Kontrabandes dhe Formave te tjera te Krimet Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës kane kryer Kontrolla Detaje te Personave dhe Mjeteve Motorike ne hyrje te Kosovës. Me ketë rast është zbuluar dhe parandaluar një rast i tentim kontrabandimit te barnave dhe pajisjeve kirurgjike te fshehura ne Autobusë.
- Me 01/12/2023 ne PKK Merdare ne kuadër te planit Operativ per Luftimin dhe parandalimin e Kontrabandes, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës kane selektuar per Kontrolle Detaje një Autobus ne hyrje te Republikës se Kosovës dhe me ketë rast ne një valixhe ne brendi te një këpuce e fshehur eshët hasur ne një arme pistolette e markës RG me nr. PTB 651, kalibrit 9mm (Knallpatr) prodhimit Gjerman. E njëjta i dorëzohet Policisë Kufitare ne PKK Merdare per trajtim te mëtejshëm te rastit.
- Me 02/12/2023 ne PKK Dheu i Bardhe ne kuadër te planit Operativ per Luftimin dhe parandalimin e Kontrabandes, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës kane selektuar per Kontrolle Detaje një Autobus ne hyrje te Republikës se Kosovës dhe me ketë rast është hasur ne një sasi te konsiderueshme te Mallrave te padeklaruara ne vlere rreth 8,000.00 Euro.
- Gjate muajit Dhjetor Njësitet Antikontrabande ne Mitrovicën e Veriut kane ofruar asistencë per Policinë e Kosovës ne 8 raste dhe me ketë rast është konfiskuar mall i kontrabanduar ne vlere mbi 80,000.00 Euro.